



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	19.05.2024
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subject/Subject:	Raport Mujor – Prill 2025

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.04.2025 deri 30.04.2025.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN PRILL 2025

1. Përmbledhje ekzekutive

Me kujdes është duke u monitoruar avancimi i shërbimeve cilësore shëndetësore. Të gjitha shërbimet në QKMF dhe punkte janë mbuluar me personel të mjaftueshëm mjekësor. Më tutje, pajisjet mjekësore kanë qenë funksionale gjatë gjithë muajit. Megjithatë, vërehet ende një përdorim i lartë i infuzioneve dhe injeksioneve në trajtimin e pacientëve, si dhe ngarkesë e madhe në laborator dhe në shërbimin e radiografisë.

Në muajin Prill kemi vizituar Qendrat e Mjekësisë Familjare në Magurë, Shalë dhe Gadime si dhe Ambulancën e Mjekësisë familjare në Dobrajë të Madhe. Nga vizitat e bëra jemi ndarë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në këto institucione. Më tutje, me personelin shëndetësor kemi diskutuar dhe jemi njoftuar me sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen dhe kemi ofruar bashkëpunim të ngushtë në lehtësimin e punës dhe avancimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Furnizimi me materiale mjekësore dhe laboratorike është bërë sipas kërkesave të sektorëve përkatës. Furnizimi nga Ministria e Shëndetësisë me barna esenciale ka qenë i pjesshëm. Furnizimi ka mbuluar rreth 65% të nevojave të QKMF-së.

Edhe muaji Prill është përcjellë me vështirësi për shkak të numrit të madh të pacientëve si pasojë e virozave sezonale.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar edhe në këtë muaj.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara, bazuar në Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024

Është bërë shënimi i ditëve botërore të shëndetësisë, përfshirë organizimin e një aktiviteti me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit. Në këtë aktivitet morën pjesë pacientë me sëmundje kronike jo ngjyterë mbi moshën 65 vjeç, anëtarë të këshillit të pacientëve, përfaqësues nga AQH, MSH, IKSHPK dhe përfaqësues të QKMF Fushë Kosovë, Viti, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë). Aktiviteti u organizua nga Drejtoria e DSHPS-së dhe QKMF-Lipjan me mbështetje nga AQH, dhe përfshiu ecje në natyrë në Grykën e fshatit Shalë, si dhe ligjërata e ushtrime fizike.

Në bashkëpunim me menaxhmentin e QKMF-së, kemi përgatitur aplikacionin për aplikim të donatorët për sigurimin e një aparati ultrasonografik me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të KPSH-së përmes ofrimit të shërbimeve ultrasonografike në QKMF në Lipjan për popullatën komunës

Në të gjitha kategoritë ekonomike janë zotuar mjetet, sipas planit të zotimit, dhe gjendja e pagesave është e mirë.

Në bazë të raporteve nga intervenimi i shërbimit të urgjencës së QKMF-së, në muajin Prill janë shënuar 15 aksidente trafiku. Krahasuar me muajin e kaluar, numri i rasteve të aksidenteve në trafik në këtë muaj ishte shumë më i ulët.

Shuma e të hyrave nga participimi në muajin prill ka qenë 8,631.00 €.

Përqindja e referimeve të jashtme për në shërbimin sekondar dhe terciar gjatë këtij muaji ka qenë 8.82% .

3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Prill janë kryer 44923 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Stafi mjekësorë	Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithsej
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i mjekësisë së Përgjithshme 20	11	9	20
Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatrisë	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 84 Bachelor=29	17	96	113
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5

Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulët-4	12	11	23
Punëtor në administratë	Shkollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Numri i punësuarve nga komuniteti jo shumice	Shkolla e mesme-3	1	2	3
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Fillore- 2 Shkolla e mesme-2	3	1	4
Gjithsej numri i punëtorëve	Shkollim superior =64, Shkollim bachelor =33, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesëm i ulët = 4	90	148	238

Totali i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në muajin Prill 2025:

Prill 2025-Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në QKMF	8366
2	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në Punte	4713
3	Vizita mjekësore Pediatrike	468
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	313
5	Vizita mjekësore Stomatologjike	658
6	Vizita mjekësore Pulmologjike	49
7	Vizita mjekësore Emergjente	5622
8	Vizita në kujdesin Paliative	293
9	Total	20482

Prill 2025- Shërbime Shëndetësore

1	Injeksione	8179
2	Infuzione	3491
3	Pastrim lidhje	1549
4	RTG	490
5	Laborator	2698
6	Lindje	0
7	Largim i penjve	56
8	Imobilizime	33
9	Oksigjenoterapi	170
10	EKG	513
11	Mamografi	11
12	USG	32

13	Vizita Shtëpiake me Autoambulancë	114
14	Transport me Autoambulancë	119
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendrën e azilit -Magure	0
17	Vizita në qendrën e paraburgimit	0
18	Rrahje	8
19	Këmbësor i lënduar me automjet	0
20	Konstatim vdekje	19
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	0
23	Aksidente trafiku	15
24	Dhunë familjare	4
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	3074
27	Vaksina	1240
29	Shërbime stomatologjike	717
30	Referime	1807
31	Inhalime	50
32	Vizita infermierie gjinekologjike	10
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	42
34	Klasa për nëna	87
33	Gjithsej shërbime	24528

4. Qendra për Punë Sociale QPS

Të dhënat numerike për numrin e klientëve dhe shërbimeve në aspektin e klientëve dhe shërbimeve të asistencës në raste dhe për ndihmë sociale gjatë muajit, Prill/2025.

Tab. 1. Shërbimin Social: Shërbimet dhe klientët.

<i>Klientët</i>	<i>Numri i rasteve</i>	<i>Shërbimet</i>	<i>Numri i rasteve</i>
<i>Fëmijët e keqtrajtuar- abuzuar (lënë pas dore)</i>	4	<i>Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin.</i>	14
<i>Të mitur në konflikt me ligjin.</i>	14	<i>Këshillim për bashkëshortët në martesë</i>	3
<i>Klient në nevojë për këshillime martesore.</i>	3	<i>Bashkimi familjar-kthimi në familje</i>	1
<i>Fëmijë me sjellje asociale- vështirësi në sjellje</i>	1	<i>Intervenim i Viktimave</i>	5

Klient me aftësi të kufizuara- të rriturit	2	Besimi i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore	3
Klient me aftësi të kufizuara- Fëmijë	1	Shërbime për të rritur fëmijë me aftësi të kufizuar	2
Viktima të trafikimit	1	Shërbime për fëmijë me sjellje asociale	1
Viktimat e dhunës në familje	5	Këshilla Psiko-Sociale	3
Viktimat e krimeve seksuale	/	Intervenime gjatë orarit të Kujdestarisë	3
Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar (me status të huaj dhe mbrojtje ndërkombëtare)	/	Pjesëmarrje në PTHT/GJTHP	5
Kërkesë për kontaktim	3	Përfaqësues të përkohshëm	1
Klient tjerë në nevojë për shërbime	56	Intervenime te pergjithshme	550
Nr. i Përgjithshëm i Klientëve.	91	Nr. i Përgjithshëm i Shërbimeve	592

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë.	5	2	7
	<i>Sa prej tyre janë të aprovuara.</i>	3	1	4
	<i>Sa janë në shqyrtim .</i>	3	1	4
	<i>Sa prej tyre janë të refuzuara .</i>	0	0	0
RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.	7	6	13
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.	101	54	155
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.	7	1	8
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara.	101	54	155
	<i>Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je odobreno.</i>	101	54	155

	<i>Sa prej tyre janë. refuzuar/çregjistruar</i>	0	0	0
KOM. MJEKËSOR	4. Numri i rasteve të dërguara. në Komision Mjekësor (KM) .	63	0	63
	<i>Numri i rasteve të aprovuara nga KM.</i>	58	0	58
	<i>Numri i rasteve të refuzuara nga KM.</i>	2	0	2
	<i>Numri i rasteve të kthyer nga KM për kompletim dokumentacioni .</i>	3	0	3
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit .	0	0	0
	<i>A. Në shkallë të parë(I).</i>	0	0	0
	<i>B. Në shkallë të dytë(II)</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të aprovuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të refuzuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave në shqyrtim.</i>	0	0	0
	<i>Kontestet në Gjykata.</i>	0	0	0
	<i>a)Kontestet të pranuar.</i>	0	0	0
	<i>b)Konteste të refuzuara.</i>	0	0	0

5. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij muaji në përgjithësi ka qenë e mirë.

6. Investimet Kapitale

Projekti Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

7. Vështirësitë dhe sfidat

- Gjatë muajit prill ka pasur një fluks relativisht të lartë të pacientëve, kryesisht për shkak të virozave sezonale dhe gripit. Rritja më e madhe e pacientëve është vërejtur në laboratorin e QKMF-së.
- Furnizimi i pjesshëm me barna dhe materiale mjekësore nga Ministria e Shëndetësisë.
- Reduktim i hapësirave të punës si pasojë e punimeve për ndërtimin e objektit të ri.
- Mungesë e stafit teknik dhe mbështetës në QKMF, si dhe prezenca e stafit të moshuar në këtë sektor.
-

8. Planifikimi për muajin Maj 2025

- Pjesëmarrja në Konferencën e Mjekësisë Familjare, më datë 14-15 Maj 2025.
- Nënshkrimi i MOU-së me AQH-në për sigurimin e një aparati ultrasonografik.
- Zbatimi i planit të veprimit për vitin 2025 dhe implementimi i shërbimeve të integruara.
- Vazhdimi i edukimit të vazhdueshëm profesional me stafin mjekësor.
- Inicimi i kërkesës për hartimin e Strategjisë për Përfshirje Sociale 2025-2027.